ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-23-10280-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **TRANSPORTI I PUNETOREVE TE KEK-ut – LOT 1**

A N K E SË

Identifikimi i ankuesit*

_____**AUTOTRANSPORTI SH.A.** _____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____**Dardhishtë, Obiliq**_____
(Adresa)

_____**OBILIQ**_____ _____**15000**_____
(Vendi) *(Kodi postar)*

_____**045 126 621**_____ _____
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

_____ **BLERIM JANUZI** _____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____ **blerim.januzi13@hotmail.com** _____
(Adresa elektronike)

_____**09.04.2024**_____
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vulat)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka filluar me njoftimin për kontrate me datë 26.09.2023

Hapja publike është bërë me datën 06.11.2023.

Njoftimi mbi vendimin e AK është publikuar me datë 05.01.2024.

Të pakënaqur me këtë vendim të Autoritetit Kontraktues, me datë 10.01.2024 i'u kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 18.01.2024 e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim si të pabazuar.

Me datë 22.01.2024 i'u kemi drejtuar AK-së me e-mail duke e kundërshtuar vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim dhe duke i kërkuar AK-së që ta revokoj këtë vendim. Edhe pse AK nuk ka kthyer përgjigje përmes e-mail-it në këtë kërkesë, me datë 24.01.2024 e ka publikuar në e-Prokurim revokimin e vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim si dhe e ka revokuar edhe Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 05.01.2024 duke e kthyer procesin edhe një herë në ri-vlerësim.

Pas rivlerësimit të tenderëve, me datë 21.03.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi

vendimin e AK-së ku të pakënaqur me këtë vendim, iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

Me datë 02.04.2024 AK ka publikuar vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

Kriter vlerësimi është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [X]

Hapja e tenderëve është bërë me datën 06.11.2023. Në procesin e hapjes nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Njoftimi mbi vendimin e AK është publikuar me datë 05.01.2024.

Të pakënaqur me këtë vendim të Autoritetit Kontraktues, me datë 10.01.2024 i'u kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 18.01.2024 e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim si të pabazuar.

Me datë 22.01.2024 i'u kemi drejtuar AK-së me e-mail duke e kundërshtuar vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim dhe duke i kërkuar AK-së që ta revokoj këtë vendim.

Edhe pse AK nuk ka kthyer përgjigje përmes e-mail-it në këtë kërkesë, me datë 24.01.2024 e ka publikuar në e-Prokurim revokimin e vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim si dhe e ka revokuar edhe Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 05.01.2024 duke e kthyer procesin edhe një herë në ri-vlerësim.

Pas rivlerësimit të tenderëve, me datë 21.03.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së ku të pakënaqur me këtë vendim, iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

Me datë 02.04.2024 AK ka publikuar vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së Nr. 04/L-042!

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së Nr. 04/L-042!

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042!

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së Nr. 04/L-042!

AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së Nr. 04/L-042!

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së.
Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të ri-vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe vetëm për qëllimin e lëndës. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara me Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Më saktësisht AK pa të drejt ka shpërblyer me kontratë për Lot 1: OE Flutura

Reisen O.P. i cili sipas mangësive që posedon në tenderin e tijë, do të duhej të cilësohej i pa-përgjegjshëm. Bazuar në nenet e cekura më lartë, shihet se AK është dashur të luaj rol aktiv në shpenzimin e parasë publike në mënyrë efikase dhe efektive dhe vetëm për qëllimin e lëndës dhe se fillimisht do duhej të sigurohej se OE janë të përgjegjshëm sipas kërkesave të njoftimit për kontratë dhe të dosjes së tenderit. Krejt kjo tregon hapur se gjatë vlerësimit të tenderëve nga ana e komisionit të dytë, komisioni dhe AK kanë shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit të tenderëve nuk i ka trajtuar aspak si të barabartë tenderuesit konkurrent. E themi këtë sepse neve na ka cilësuar si të pasuksesshëm ndërsa OE që e ka shpallur fitues e ka cilësuar të përgjegjshëm edhe pse ka mangësi të theksuara në tenderin e tijë. Ky OE ka mangësi në specifikimi teknik të Minibusëve dhe ka mangësi edhe tek patent-shoferët. Krejt kjo tregon që AK e ka favorizuar dukshëm OE Flutura Reisen O.P. duke e shpallur fitues edhe pse është i papërgjegjshëm ndërsa në të njëjtën kohë na ka diskriminuar neve si tenderues plotësisht i përgjegjshëm. Sjellja e tillë e AK-së e shtynë këtë të fundit drejt shkeljes së plotë të nenit 7 të LPP-së.

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë procesit të ri-vlerësimit të tenderëve ka vlerësuar në kundërshtim të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe në kundërshtim me kërkesat e LPP-së. E themi këtë sepse komisioni i parë neve na ka propozuar si fitues ndërsa OE Flutura Reisen O.P. e ka eliminuar me të drejtë si të papërgjegjshëm pasi që i njëjti kishte mangësi të theksuara në tenderin e tijë. **Kjo nuk i pëlqeu dikujt nga zyra e prokurimit** andaj pa asnjë arsye ligjore të bazuar, e ndryshoi komisionin dhe në bashkëpunim me ta, e favorizuan OE Dita Travel SHPK duke ja plotësuar, ndryshuar dhe modifikuar ofertën vetëm sa për ta shpallur fitues. Pas ankimimit tonë tek AK, kjo e fundit edhe këtë OE e cilëson të papërgjegjshëm dhe tenderin për Lot 1 ia beson OE Flutura Reisen O.P.. Të pakënaqur me veprimet e tilla kundërligjore po ankimojmë këtë vendim dhe këtë sjellje jo profesionale e jo ligjore të AK-së. Në vazhdim po e argumentojmë arsyetimin e pabazuar të AK-së për shpallje si fitues të OE Flutura Reisen O.P.

AK ka shkelur nenin 59.4 të LPP-së me rastin e rivlerësimit dhe sqarimit të tenderit të OE Flutura Reisen O.P. pasi që gjatë këtij procesi ia ka mundësuar ndryshimin dhe plotësimin substancial të tenderit duke ia ka pranuar edhe shumë mangësi thelbësore të cilat këtë OE e bënin të pa-përgjegjshëm.
Fillimisht po e sqarojmë çështjen e mangësive tek pajisjet e kërkuara ku ndër të tjera AK kishte kërkuar që OE të posedonin këto pajisje:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
		LOT 1 Transporti i punëtorëve të KEK-ut relacioni Prishtina-1 Prishtina-2 Podujeva Ferizaj- KEK dhe anasjelltas	
		2.Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik	**2. Minimumi i pajisjeve:** **a) Autobus ..... 25 cope** **b) Minibus (mbi 18 ulëse)..... 3 cope** **Te dëshmohet me kopje te librezes se qarkullimit dhe kopje te certifikatës se kontrollës teknike të lëshuar nga organet kompetente brenda afateve ligjore**

Si përgjigje ndaj kësaj kërkese shihet se ky OE kishte paraqitur një listë prej 30 pajisjeve ku 27 janë autobus ndërsa 3 janë minibus. Sipas kërkesës shihet se minibusët ndër të tjera duhet të plotësonin **kushtin decidiv** të vendosur nga AK të cilët duhet të posedonin **mbi 18 ulëse** secili. **Sipas kësaj kërkese minimumi i ulëseve do duhej të ishte 19 ulëse.** Ky OE i ka paraqitur 3 minibus të cilët nuk e plotësojnë këtë kusht sepse posedojnë vetëm nga 18 ulëse. Ja si duket njëra nga librezat e regjistrimit ku dëshmohet se kombibusi posedon vetëm 18 ulëse ku ngjashëm me këtë janë edhe dy të tjerët.:



Pra bazuar në kërkesën e AK-së shihet se këta minibus do duhej që të posedonin së paku 19 ulëse ndërsa nga OE i shpallur fitues janë paraqitur me 18 ulëse dhe si të tillë nuk mund të pranohen. Për qëllim të sqarimit të asaj se çka nënkupton posedimi i 18 ulëseve dhe çka është kërkuar me kërkesën **mbi 18 ulëse** po paraqesim një skicë të boshtit numerik.



Në bazë të kësaj po shihet se AK nuk e ka respektuar kriterin e vet ndërsa OE i shpallur fitues nuk ka arritur të paraqesë minibusët sipas kërkesës së dosjes së tenderit të cilët detyrimisht është dashur të jenë me së paku 19 ulëse. Kërkesa mbi 18 ulëse nuk e përfshinë ulësen 18 por detyrimisht duhet të jenë 19 ulëse e më shumë.
Me që sipas kësaj po shihet se kushti i kërkuar për pajisjet nuk është plotësuar, del që OE Flutura Reisen O.P. të jetë i papërgjegjshëm për Lotin 1 të këtij tenderi. Pikërisht për këtë mangësi dhe mangësi tjera, dy komisione nga i njëjti AK fillimisht e kanë shpallur të papërgjegjshëm. Veprimi i AK-së duke e shpërblyer këtë OE në kundërshtim me ligjin dhe me kërkesat e AK-së, shihet edhe si interes i dikujt nga vet zyrtarët e KEK-ut dhe për ta kuptuar këtë nuk ka nevojë për ndonjë mundim të madh. Pra mungesa e pajisjeve sipas kërkesës së AK-së, OE Flutura Reisen O.P. e bënë konkurrent të papërgjegjshëm ndërsa vlerësimi i AK-së shihet se është bërë në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Mangësia e dytë që ky tenderues e posedon në tenderin e tijë është se gjatë tenderimit ka dorëzuar patent-shoferët për 13 persona me afat të skaduar për kategorinë e kërkuar. AK pa të drejt ligjore dhe kundër asaj që e mundëson neni 59.4 dhe 72 i LPP-së, ka kërkuar sqarime dhe ka lejuar plotësim substancial të këtij tenderi duke i pranuar me sqarim dokumente tjera në krahasim me ato që janë dorëzuar fillimisht me tender. Arsyeja pse mendojmë kështu është sepse kemi të bëjmë me pranim të një dokumenti krejt tjetër në krahasim me atë që ishte i dorëzuar në tenderin e tij fillestar. Ja dëshmia e plotësimit substancial për një nga shoferët e që ngjashëm me këtë ia ka lejuar sqarimet edhe për shtatë shofer të tjerë (*shihni dosjen e AK-së për procedurën në fjalë*):

I dorëzuar me tender	I dorëzuar me sqarime
	

Pra po shihet se kemi të bëjmë me ndryshim dokumenti sepse numri i dokumentit të dorëzuar me sqarim dallon nga ai fillestar. Numri i dokumentit që ishte dorëzuar në fillim është DL31036525 ndërsa numri i dokumentit të pranuar me sqarime është DL31448277. Në rast kërkese për sqarim kur dorëzohet ndonjë dokument tjetër në krahasim me atë që ishte dorëzuar në fillim, sipas nenit 59.4 të LPP-së konsiderohet plotësim substancial sepse është ndryshuar kushti material dhe aspekti i tenderit ne fjalë. Kjo ligjërisht nuk do duhej pranuar andaj konstatojmë se tenderuesi në fjalë nuk ka arritur ta plotësoj kushtin e kërkuar të dosjes së tenderit lidhur me shoferët dhe rrjedhimisht është dashur të konsiderohet tenderues i papërgjegjshëm.

Si veprim është paksa edhe i dyshimtë sepse shtrohet pyetja: nga e kuptuan AK dhe komisionet e vlerësimit se OE i tillë i posedon patent-shofer tjerë me afat të rinovuar edhe pse në tender i ka dorëzuar patent-shoferët pa validitet vetëm për kategoritë e kërkuara? Kjo tregon se AK përkatësisht persona të caktuar brenda AK-së kanë bashkëpunuar ngushtë me këtë OE deri sa ja kanë arritur qëllimit që ta shpallin edhe si fitues. Si u bë që dy komisione të të njëjtit AK të ja atribuojnë si mangësi këtë fakt dhe ta shpallin të papërgjegjshëm ndërsa komisioni i tretë të i mbyllë sytë para një mangësie të tillë dhe ta lejoj këtë OE që ta plotësoj tenderin e tijë në mënyrë substanciale në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së.

Pra ndryshimi i patent-shoferëve nuk është dashur të lejohet sepse kemi të bëjmë me dokumente të ndryshme që posedojnë numrin e dokumentit ndryshe nga ai i dorëzuar me tender. Duke marrë parasysh vlerësimin e tenderit tonë dhe atë që e ka shpallur fitues, AK del të ketë shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së dhe vet kërkesat e tijë që i kishte vendosur tek dosja e tenderit. Të gjitha dëshmitë për këto pretendime i gjeni të bashkangjitura por edhe mund të i gjeni tek dosja e lëndës në AK.

4. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat e projektit. AK ka vendosur shumë kritere dhe kërkesa që lidheshin me nenin 69 të LPP-së por që shumë nga këto kritere nuk i ka zbatuar si duhet gjatë procesit të vlerësimit. Shumicën e këtyre kritereve i ka anashkaluar kur ishte në pyetje vlerësimi i tenderuesit të shpallur fitues. Këtu përpos që kemi të bëjmë me mos aplikim të drejtë të kritereve të dosjes dhe kërkesave të nenit 69 të LPP-së, kemi të bëjmë edhe me favorizim të OE të shpallur fitues dhe mos respektim të kërkesave lidhur me pajisjet dhe dokumentacionin tjetër të kërkuar në dosje të tenderit.

5. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së gjatë procesit të ri-vlerësimit sepse ka kërkuar sqarime në kundërshtim me mundësitë ligjore si dhe e ka lejuar OE në fjalë që ta plotësoj tenderin substancialisht me dëshmi të tjera në krahasim me ato që ishin dorëzuar fillimisht me tender. Shumë qartë tregohet në nenin 72 i LPP-së, si duhet vepruar për të sqaruar paqartësitë në tenderët konkurrues andaj në vazhdim po paraqesim vetëm atë që e kërkon nenin 72 i LPP për sqarim të tenderëve:

Neni 72
Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Patent-shoferët e dorëzuar janë dëshmi të plota, nuk janë të gabuara sepse saktë i përgjigjen kërkesës dhe gjithashtu nuk mungojnë por janë dorëzuar të gjitha ashtu siç janë kërkuar. Sipas kësaj, asnjëri nga kushtet e nenit 72.1 të LPP-së nuk është plotësuar që AK-së të i jepet e drejta për të kërkuar sqarime shtesë andaj veprimi i tillë konsiderohet i jashtë ligjshëm dhe favorizim i hapur i këtij OE.

Këtu shihet se AK e ka keqpërdorur këtë nen kur ka kërkuar sqarime nga OE Flutura Reisen O.P. dhe njëherit kur ia ka mundësuar ndryshim dhe plotësimin substancial të ofertës. Këtë e elaboruam shumë qartë tek pretendimi mbi shkeljen e nenit 59 të LPP-së andaj nga kjo kuptohet qartë se AK ka shkelur edhe nenin 72 të LPP-së.

Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato që thamë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të aprovoj pretendimet tona si të bazuara dhe më pas të merr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE **AUTOTRANSPORTI SH.A.** lidhur me tenderin "**TRANSPORTI I PUNETOREVE TE KEK-ut – LOT 1**" i iniciuar nga **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..**

ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin e AK – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.** dhe lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM.**

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit, të LPP-së dhe të Ligjit për Automjetet ku më pas do duhej që **Fitues** të shpallej **OE AUTOTRANSPORTI SH.A..**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 1 Njoftim per Kontrat
- 2 Dosja e Tenderit
- 3 LOT-I- Pershkrimi cmimeve
- 4 Procesverbali i Hapjes
- 5 Raporti i vleresimit - hera e parë
- 6 Raporti i Vlersimit te tenderve - hera e dytë
- 7 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK - LOT 1
- 8 Leter Standarde per tenderuesin e eleminuar Lot 1 A...T SH.A.
- 9 KERKESE PER RISHQYRTIM - AUTOTRANSPORTI 10.01.2024
- 10 RISHQYRTIMI I KERKESES KEKO-23-351-211 18.01.2024
- 11 Njoftim per revokim te vendimeve
- 12 LOT-1 dhe LOT-3 NJOFTIM MBI VENDIMIN
- 13 Lot 1 DHE 3 AUTOTRANSPORTI Letra stamdarde
- 14 Sqarimet e OE FLUTURA - 27.11.2023
- 15 Sqarimet e OE FLUTURA - 10.03.2024
- 16 KERKESE PER RISHQYRTIM - AUTOTRANSPORTI 26.03.2024
- 17 Rishqyrtimi i kerkeses AUTOTRANSPORTI - 02.04.2024

Vërejtje: **Të gjithë materialin në të cilin i kemi mbështetur pretendimet tona e gjeni të bashkangjitur kësaj ankese ndërsa në materialin e procedurës së prokurimit që ndodhet në e-Prokurim e gjeni në lëndën e procedurës!**

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*